# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: Kuvendi Komunal Mamushe

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **626-20-16-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **"Furnizimi me dru dhe pelet per ngrohje"**

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj: **N.T.SH "NAZI TRAVEL"**
Adresa: **Rr. "Jakup Ferri" Nr.5, Prishtinë**
Vendi: **Prishtinë**
Kodi postar: **10000**
Numri Telefonit: **044 440261**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Bedri Murtezi**
Adresa elektronike: **ntshnazitravell@gmail.com**
Data e parashtrimit të kërkesës: **22.07.2020**

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

______________________________
*(Emri i avokatit)*

______________________________
*(Adresa e plotë)*

________________ ________________
*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

________________
*(Adresa elektronike)*

________________ ________________
*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| Aktiviteti i prokurimit **"Furnizimi me dru dhe pelet per ngrohje"** është publikuar me datë 03.06.2020, afati i fundit per dorezimin e ofertave ka qenë 25.06.2020. Ofertat i kanë dorëzuar 4 operator ekonomik. Hapja e ofertave është bërë me datë 25.09.2018 në ora 14:00 ne menyre elektronike. |

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [X] **Jo** [ ]

| |
|---|
| |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [X] **Jo** [ ]

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**AK K.K. Mamush ka shkelur dispozitat në vijim të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik:**

- **Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP-së**; dhe
- **Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,** paragrafi 1 dhe paragrafi.

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

**OE N.T.SH. "Nazi Travel" konsideron se AK K.K. Mamushe nuk e ka trajtuar drejtë/barabrtë dhe në bazë të kritereve të vendosura në dosjen e tenderit oferten e tij. Detajet mbi faktet dhe argumentet e OE N.T.SH. "Nazi Travel" janë si në vijim:**

**Është shkelur neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafin 2 të LPP-së** duke ekzekutuar aspekte të aktivitetit të prokurimit që reduktojnë konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik dhe diskriminojnë në dëm të operatorit ekonomik N.T.SH. "Nazi Travel" dhe duke mos i shqyrtuar drejtë dokumentet e ofruara nga O.E;

**Është shkelur neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve** duke mos i shqyrtuar drejte dhe ne baze te kerkesave te paraqitura ne dosjen e tenderit te AK K.K. Mamushe deshmite e kerkuara dhe te ofruara nga O.E. N.T.SH. "Nazi Travel" dhe gjithashtu duke kerkuar dokumente shtese per O.E, te cilat nuk jane kerkuar me dosjen e tenderit.

Rrjedhimisht, arsyet qe jane dhene per eleminimin nga konkurrenca te O.E N.T.SH. "Nazi Travel" jane te pa baze.

Arsyet e dhena nga A.K. K.K.Mamushe per eleminimin nga konkurrenca te O.E N.T.SH. "Nazi Travel" jane:

1. Nuk i keni ofruar minimum tri referenca; dhe
2. Njeri nga kamionet ka kapacitet me te vogel se 7 ton.

**Sqarimet tona kunder arsyetimit te pare te eleminimit te dhene nga AK K.K. Mamushe jane:**

Ne dosjen e tenderit te AK tek neni 9.1 & 9.2 "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale jane keto kerkesa:

**Kapaciteti teknik dhe professional**

**1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimumi tre kontrata gjate tri viteve te fundit.**

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

**1. Lista e projekteve të realizuara për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës( transaksioni bankar fatura etj).**

**Pra A.K. K.K. Mamushe ne dosjen e tenderit nuk e ka cekur se duhet ofruar <u>minimum 3 referenca</u> por vetem citim nga pragrafi me larte "Reference", duke e shkelur keshtu LPP.**

**Sqarimet tona kunder arsyetimit te dyte te eleminimit te dhene nga AK K.K. Mamushe jane:**

**2. OE duhet te ofroj dëshmi se posedon makinerinë dhe mjetet e punës, te domosdoshme për furnizim me dru dhe pelet, së paku 3(tre) kamionë min. 7 ton, si dhe së paku nje ngarkues. Vlen për të dy pjesët.**

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

**Lista e makinerisë dhe mjeteve te punës qe do te përdoret ne realizim te projektit, origjinale e nënshkruar dhe vulosur nga O.E, e dëshmuar me dokumentacion te pronësisë (Duhet të kopjohen Certifikatat e Regjistrimit të automjetit (CRA) të mjeteve ose dokumenti unik doganor (DUD) dhe të paraqiten me rastin e tenderimit) ose nëse merren në shfrytëzim (kontrata origjinale për shfrytëzim si dhe dëshmitë e pronësisë së dhënësit në shfrytëzim të cekura më lartë)**

**O.E N.T.Sh. "Nazi Travel" ka ofruar deshmite e kerkuara nga AK K.K.Mamushe se posedon 3 kamion min 7 ton. Shih deshmite ne vijim:**

**Kamioni me targa 01-245-KF dhe peshe 7490 kg;**
**Kamioni me targa 01-961-II dhe peshe 17,600 kg; dhe**
**Kamioni me targa 01-621-IP dhe peshe 16,000 kg.**

**Prandaj, kerkojm nga AK K.K.Mamushe qe duke i rishqyrtuar faktet qe i kemi ofruar, ta**

**ndryshoj vendimin per dhenjen e kontrates per aktivitetin e prokurimit ne fjale, ne te kunderten ne do t'i drejtohemi OSHP dhe organeve tjera kompetente.**

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**OE N.T.SH. "Nazi Travel" është taksapagues i rregullt i taksave dhe tatimeve të vendosura me ligjet dhe aktet tjera nën ligjore të Republikës së Kosovës, që janë pjesë e të hyrave shtetrore dhe se një diskriminim dhe trajtim jo i bartabart nga ana e autoriteteve komunale e dëmton dhe pamundëson materialisht zhvillimin dhe funksionimin e veprimtarisë së operatorit N.T.SH. "Nazi Travel".**

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë";*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës";*
*c) një kopje të letrës se tenderuesit të pasuksesshëm;*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve;*
*e) disa kontrata me referenca;*
*f) kopjet e librezave te tre kamioneve me peshe min 7 ton.*

KOMUNA E MAMUSHËS

# NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ ***PUNË*** ☒ ***FURNIZIM*** ☐ ***SHËRBIME***

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit: 03.06.2020**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **626-20-2480-1-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **626-20-16-1-2-1** |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☐

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: **KOMUNA E MAMUSHËS** | | |
| **Adresa Postare**: **Rruga "Sahat Kulesi" nr. 44 Ndërtesa e Komunës së Mamushës** | | |
| Qyteti: **Mamushë** | Kodi postar: **20540** | Vendi: **Kosovë** |
| **Personi kontaktues**: **Gazmend Gashi** | | Telefoni: **03820045211** |
| Email: **mamushaprokurimi@gmail.com** | | Faksi: |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*: | | |

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

***Nëse po***, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
**FURNIZIMI ME DRU DHE PELET PËR NGROHJE**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

| ☐ **Punë** | ☒ **Furnizime** | ☐ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☐ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☒ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
**Furnizimi do të bëhet ne objektet e Shkollës Fillore, Shkolla e Mesme, QMF-n si dhe KK Mamushë.**

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj**

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**
**Lënda e kësaj kontrate ka të bëj me Furnizimin me dru për ngrohje, për objektin e shkollës fillore, dhe Qendrën e mjeksisë familjare, kurse Furnizimi me pelet për KK Mamushë dhe Shkollën e mesme.Në bazë të kësaj kontrate do të furnizohemi me dru 400(katërqind)m2,si dhe me 37( tridhjeteshtatë) ton pelet.**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**

**02130000-4**

**II.1.7) Variantet pranohen**

**Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë**

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po,*** tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☒ Të gjitha pjesët

**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët** (*nëse aplikohen)*

| Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|---|
| **Grupi 1.** | **FURNIZIMI ME DRU** | **Lënda e kësaj kontrate ka të bëjë me furnizimin me dru për objektin e Skkollës Fillore dhe QMF-n.Në bazë të kësaj kontrate do të furnizohemi me 400(katërqind)m³ dru.** |
| **Grupi 2.** | **FURNIZIMI ME PELET PËR NGROHJE** | **Furnizimi me pelet Lënda e kontrates ka të beje me Furnizimin me pelet per ngrohje per objektin e Shkolles se Mesme dhe KK Mamushes.Në bazë të kësaj kontrate do të furnizohemi me 37 (tridhjeteshtat) ton pelet.** |

**Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është: 2**

**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 21 000,00**

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
**Furnizimi me dru dhe pelet Ky prokurim ka të bëjë me furnizimi me dru dhe pelet për ngrohje per KK Mamushë,Shkolla Fillore,Shkollën e Mesme si dhe QMF-n.Kontrata për këtë prokurim do të lidhet me operatorin ekonomik fitues të këtij tenderi, do të filloj të zbatohet menjëher pas nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.**

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë **15** (nga dhënia e kontratës)
*apo*
Fillimi
Përfundimi

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

### III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**

**Po** ☒ **Jo** ☐

*Nëse po*, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10%** % e vlerës së kontratës

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** *(nëse aplikohet)*:

**Forma ligjore që do të merret përmes grupit do të jetë forma e përcaktuar në nenin 71 të LPP-së dhe nenin 27 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik.**

**III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta

### III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

| **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| **1)Deklarata nën betim se Operatori Ekonomik i plotëson kushtet në bazë të nenit 65 Paragrafi 65.1 pikat 1.1; 1.2; 1.3 të LPP-s** | **1)Deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe e vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 3 të dosjes së tenderit.** |
| **2) Operatori Ekonomik nuk duhet të jetë në falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë pranë ndonjë Gjykate kompetente e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik.** | **2) Një vërtetim apo certifikatë origjinale (ose kopje e noterizuar) i lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes së ofertave.** |
| **3)Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit.** | **3)Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik,Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet, vetëm nga Operatori Ekonomik qe rekomandohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës.** |
| **4) Operatori ekonomik duhet të ketë paguar taksat komunale të biznesit në vendin e themelimit te biznesit së paku deri në periudhën e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë.** | **4) Vërtetimi apo certifikata nga Komuna në të cilën është themeluar biznesi .Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 60 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes së ofertave** |
| **5) Operatori ekonomik duhet të ketë paguar tatimin në pronë në vendin e themelimit te biznesit së paku deri në periudhën e fundit nga** | **5) Vërtetimi apo certifikata nga Komuna në të cilën është themeluar biznesi .Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe** |

| | |
|---|---|
| data e publikimit te njoftimit për kontratë. | propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 60 ditë nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes së ofertave. |
| **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**<br>1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin përkatës profesional, të bizneseve dhe ose të korporatave | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br>1. Kopja e Certifikatës së biznesit së bashku me pjesët informative të biznesit. |
| 2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë deklarues të TVSH-së | 2. Kopja e certifikatës së TVSH-së të lëshuar nga Organi Kompetent |
| 3. Operatorë ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë regjistruar numrin fiskal në ATK | 3. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të numrit fiskal (nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit). |
| **III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**<br>1.Per pjesen e pare Operatorët Ekonomik duhet të kenë një qarkullim financiar në tri vitet e fundit së paku 25,000.00 € ,ndersa per pjesen e dyte 14,000.00.nga data e shpallje së kësaj kontrate.Ne rastë se Operatori Ekonomik aplikon Per te dy pjeset vlera e 25,000.00 euro do ti mbuloj te dy pjeset. | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br>1. Raportin,raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore ne ATK me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar. |
| **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:**<br>1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimumi tre kontrata gjate tri viteve te fundit . | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*<br>1. Lista e projekteve të realizuara për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë shërbimet e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës( transaksioni bankar fatura etj). |
| 2. OE duhet te ofroj dëshmi se posedon makinerinë dhe mjetet e punës, te domosdoshme për furnizim me dru dhe pelet, së paku 3(tre) kamionë min. 7 ton, si dhe nje ngarkues , kjo kerkes vlen për te dy llotet. | Lista e makinerisë dhe mjeteve te punës qe do te përdoret ne realizim te projektit, origjinale e nënshkruar dhe vulosur nga O.E, e dëshmuar me dokumentacion te pronësisë (Duhet të kopjohen Certifikatat e Regjistrimit të automjetit (CRA) të mjeteve ose dokumenti unik doganor (DUD) dhe të paraqiten me rastin e tenderimit) ose nëse merren në shfrytëzim (kontrata origjinale për shfrytëzim si dhe dëshmitë e pronësisë së dhënësit në shfrytëzim të cekura më lartë) |
| 3. Opertatorët ekonomik duhet të kenë staf të | 3.Listën origjinale të punëtorëve të O.E. të |

| | |
|---|---|
| mjaftueshëm për realizim të kontratës, minimum 6 punëtor. Vlen për të dy pjesët. | nënshkruar dhe vulosur nga O.E. si dhe kontratat e punëtorëve. |

### III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

**Po** ☐ **Jo** ☐

**III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar**

***Nëse po,*** referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve**

**Po** ☐ **Jo** ☐

## NENI IV: PROCEDURA

### IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

**IV.1.1) Lloji i procedurës**

☒ **E hapur**

☐ **E kufizuar**

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

**IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

**IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

**Po** ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

**Po** ☐ **Jo** ☐

**IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është**:

**IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik**

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

## IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

*ose*

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,***

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

**Po** ☐ **Jo** ☒

Dokumentet me pages

***Nëse po***, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

**IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:***

***data*** **25.06.2020** ***koha*** **14:00:00** ***vendi*** **Tenderët duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike përmes platformës elektronike të KRPP-s ne adresën e AK-s.**

**IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:**

☐ **Po** ☒ **Jo**

***Nëse po***, jep arsyetim

**IV.3.4)** A është e nevojshme siguria e tenderit:

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë *apo* muaj

**IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**

Deri më: data: ditët **60** apo muajt

**IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:**

**data 25.06.2020 koha 14:00:00 vendi Objekti i Komunës së Mamushës-Zyra e prokurimit nr. 17**

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

## V.1) ANKESAT

**Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit**

**108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.**

## V.2) INFORMACIONET SHTESË

**Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**
*Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)*

# PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

| | | | |
|---|---|---|---|
| Numri i prokurimit<br>Procurement number<br>Broj nabavke: | **626-20-2480-1-2-1** | Titulli i Kontratës<br>Contract Title<br>Naslov ugovoru | **FURNIZIMI ME DRU DHE PELET PËR NGROHJE** |
| Numri i brendshëm<br>Internal No<br>Interni broj | **626-20-16-1-2-1** | | |

| Data e lëshimit<br>Date of issue<br>Datum izdavanja | Data e mbylljes<br>Closing date<br>Datum zatvaranja & Čas | Data e hapjes & Ora<br>Opening date & time<br>Datum Otvaranja & Čas | Vendi<br>Place<br>Mesto | Nr. i tenderëve të pranuar<br>No. of Received Tenders<br>Br. Primljenih Tendera |
|---|---|---|---|---|
| **25.06.2020** | **25.06.2020, 14:00:00** | **25.06.2020, 14:00:00** | **Objekti i Komunës së Mamushës-Zyra e prokurimit nr. 17** | 4 |

| Nr.<br>Br. | Tenderuesi<br>Tenderer<br>Tenderer | Kodi i tenderit<br>Tender label /code<br>Oznaka ponude | Pjesë<br>Lot<br>Lot | e-tenderit<br>e-tender<br>e-ponuda | Çmimi<br>Price<br>Cena<br>€ | Çmimi (me TVSh)<br>Price (with VAT)<br>Cena (sa PDV)<br>€ | Ndryshimi/plotë mi<br>Suplement/Ame ment<br>Dpuna/Izmjena |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **Grup i Operatorëve Ekonomik Abit Kastrati B.I.; AGRO COM SH.P.K., OBILIQ I RI, -, OBILIQ** | **Mamusha 2020** | **FURNIZIMI ME DRU** | **PO** | **12874,56** | **15192,00** | **JO** |
| 2. | **Grup i Operatorëve Ekonomik Abit Kastrati B.I.; AGRO COM SH.P.K., OBILIQ I RI, -, OBILIQ** | **Mamusha 2020** | **FURNIZIMI ME PELET PËR NGROHJE** | **PO** | **6584,74** | **7770,00** | **JO** |
| 3. | **" AOME " SH.P.K., Gjeravica, 10000, KOLOVICE** | **92/2020 AM** | **FURNIZIMI ME DRU** | **PO** | **14711,86** | **17360,00** | **JO** |
| 4. | **" AOME " SH.P.K., Gjeravica, 10000, KOLOVICE** | **92/2020 AM** | **FURNIZIMI ME PELET PËR NGROHJE** | **PO** | **5894,92** | **6956,00** | **JO** |
| 5. | **N.T.SH. " NAZI TRAVEL ", Rr. Jakup Ferri nr. 15, 10000, Prishtine** | **626-20-2480-1-2-1** | **FURNIZIMI ME DRU** | **PO** | **11200,00** | **13216,00** | **JO** |
| 6. | **N.T.SH. " NAZI TRAVEL ", Rr. Jakup Ferri nr. 15, 10000, Prishtine** | **626-20-2480-1-2-1** | **FURNIZIMI ME PELET PËR NGROHJE** | **PO** | **6114,41** | **7215,00** | **JO** |
| 7. | **N.P.T. " Burimi ", p.n, -, SOPI** | **Burimi** | **FURNIZIMI ME DRU** | **PO** | **13920,00** | **13920,00** | **JO** |
| 8. | **N.P.T. " Burimi ", p.n, -, SOPI** | **Burimi** | **FURNIZIMI ME PELET PËR NGROHJE** | **PO** | **6837,68** | **6837,68** | **JO** |

**Komente nga përfaqësuesit e pranishem**
**Comments from the present authorized representatives of the CA and the EO at the opening of tenders:**
**Komentari prisutnih ovlaštenih predstavnika UA i EO na postupak otvaranja ponuda**

**Nuk ka.**

## Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO

| Nr.<br>Br | Tenderuesi, Emri / Mbiemri<br>Tenderer, Name / Surname<br>Tenderer, Ime / Prezime | Nënshkrimi<br>Signature<br>Potpis |
|---|---|---|
| | | |

## Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

| Emri Mbiemri<br>Name Surname<br>Ime Prezime | Nënshkrimi/ Signature/ Potpis | Datë/ Date/ Datum |
|---|---|---|
| Mehmet Morina | | |
| Aziz Elshani | | |
| Gazmend Gashi | | 25-06. 2020 |
| Derya Kala | | 25.06.2020 |

**Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:**

**Gazmend Gashi**

* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŞA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

# Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

**Data: 10.07.2020**

**KOMUNA E MAMUSHËS**

**Adresa e AK: Rruga "Sahat Kulesi" nr. 44 Ndërtesa e Komunës së Mamushës - ZYRA PROKURIMIT,e-mail** - mamushaprokurimi@gmail.com

**Emri: Operatori Ekonomik NTSH "NAZI TRAVEL",Rr.Jakup Ferri nr.15. 10000. Prishtinë**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. i prokurimit: | 6 2 6 | 20 | 2480 | 1-2-1 |
| Nr. I brendshem | 6 2 6 | 20 | 016 | 1-2-1 |

**Titulli: "Furnizimi me dru dhe pelet për ngrohje"**

I nderuar Z.**BEDRI MURTEZI**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".
Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të tenderit në fjalë, konkretisht ofertës tuaj, ka konstatuar që O.E me nr. rendor *5 (pesë)* Operatori Ekonomik **NTSH "NAZI TRAVEL", ka dorëzuar listën e projekteve sipas së cilës ka deklaruar se e ka dorëzuar listën e projekteve , mirëpo nuk keni ofruar referenca në vlerë prej 25,000.00 €, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.**

**Gjithashtu duke u bazuar në nenin 9.1 & 9.2 pika 2 të dosjes së tenderit, është kërkuar që OE duhet te ofroj dëshmi se posedon makinerinë dhe mjetet e punës, te domosdoshme për furnizim me dru dhe pelet, <u>së paku nje ngarkues</u> e cila vlen për të dy pjesët, ndërsa si dëshmi është kërkuar: Lista e makinerisë dhe mjeteve te punës qe do te përdoret ne realizim te projektit, origjinale e nënshkruar dhe vulosur nga O.E, e dëshmuar me dokumentacion te pronësisë <u>(Duhet të kopjohen Certifikatat e Regjistrimit të automjetit (CRA) të mjeteve ose dokumenti unik doganor (DUD)</u> dhe të paraqiten me rastin e tenderimit) ose nëse merren në shfrytëzim (kontrata origjinale për shfrytëzim si dhe dëshmitë e pronësisë së dhënësit në shfrytëzim të cekura më lartë).**

**Ju në tenderin tuaj nuk keni dorëzuar dokumenti unik doganor (DUD-in) apo Certifikatat e Regjistrimit të automjetit (CRA).**

**Duke u bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-s me qëllim të vlerësimit të drejtë të tenderit tuaj, kërkojmë që të na jepni sqarime në lidhje me dëshminë e lartcekur. Në rast se posedoni Referencat e cekura në listë, si dhe Dokumentin Unik doganor (DUD-in) apo Certifikatat e Regjistrimit të automjetit (CRA), duhet të na sillni tek ne të skanuara përmes platformës elektronike, e-mailit ose kopje fizike.**

***Ju njoftoj se në bazë të nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve (Dokumentet duhet te kenë datën e lëshimit para dorëzimit të tenderit) dhe mund të verifikohen në mënyrë objektive.***

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohet prej nesh në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues brenda afatit prej 6 **(Gjashtë) ditëve** nga data e kësaj kërkese, **përkatësisht deri me 15.07.2020 ora 13:30**

